



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	04.04.2018
Referencë	11-344/3
Për :	Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-MARS



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin –Mars

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	I Gjobë mandatore	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Pëiqime sanitare	Menaxhim i tregjeve	Aktivdime- ndalesa, urdhëresa	Biznese pa pranime teknike	Kërkesa, pune me palë	Të hyrat nga pranimet teknike	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Biznese të paregjistruara	Mallë me afat të skaduar
Biznesit	366	41	18			18		4		8	67	14	186	350.00			10	
Ambientit	78	30				6					1		41					
Bujqësisë	72	13				22							37					
Ndërtimtarisë	22	12					1	1			1		7					
Trafikut	109	2		2		34		2		8			25			36		
Sanitar	125	41		3	22	34		1	1				12		11			69kg
Gjithsejtë	772	139	18	5	22	114	1	8	1	16	69	14	308	350.00	11	36	10	69kg

Gjatë muajit Mars kemi hasur në 10 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan. Gjithashtu kemi pasur 14 biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit.

Kemi vazhduar me inspektimin e disa prej kafiterive në qytet, përveç kafiterive kemi filluar me inspektimin e restoranteve në qytet si dhe kemi inspektuar disa nga restorantet në Aeroportin Ndërkombëtarë "Adem Jashari", të gjitha janë inspektuar në aspektin higjienik dhe për të gjitha mangësitë është dhënë urdhër me procesverbal për eliminimin e tyre. Gjatë muajit kemi bërë një inspektim në kampin e njësisë speciale në fsh. Vrellë në bazë të një ankese, ku pastaj kemi njoftuar edhe Inspektorët Sanitarë të AUV-it të cilët janë marrë me ankesën në fjalë. Kemi bërë inspektimin e dëmtimit të një gypi i cili furnizon me ujë banorët e fsh. Banullë, ky gyp është dëmtuar gjatë hapjes së gropës për vendosjen e një shtylle elektrike nga punëtorët, gjegjësisht divizioni për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të KEDS-it, ku gypi është sanuar brenda ditës. Gjatë muajit është bërë inspektim i disa subjekteve afariste ushqimore të cilat gjenden afër shkollës në Gadime.

Është organizuar një aksion ku është bërë inspektimi i marketeve në qytet dhe fshatra, në veçanti i sektori i mishit dhe produkteve të tij si dhe i mishoreve ku gjatë inspektimit është gjetur mish dhe sugjuk i pa përshtatshëm për konsum në vlerë prej 62 KG, malli është asgjësuar në vend dhe ndaj subjekteve afariste është bërë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje (Fletëparaqitje).

Inspektorët kanë dalë në teren sipas ankeseve të qytetarëve në lidhje me problemet me ujëra të zeza, kanalet për ujërat atmosferik, plehun e kafshëve të hedhura në hapësira publike, hedhje të mbeturinave në prona private, ku për çdo problem është konstatuar gjendja dhe janë dhënë urdhëresat për mënjanimin e parregullsive.

Janë inspektuar disa deponi ilegale të mbeturinave për gjatë magjistrale Lipjan-Shtime si dhe disa fshatra se mos po hasen qytetarë duke hedhë mbeturina, pastaj janë marr masa ligjore ndaj bizneseve në qytet për menaxhim jo të mirë, shpërndarja dhe ndezje të mbeturinave.

Janë inspektuar bizneset në qytet të cilët shfrytëzojnë hapësirën publike, janë urdhëruar që të fillojnë të aplikojnë tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe t'i kryen obligimet (pagesat) sipas rregulloreve komunale dhe të pajisen me pëlqim nga drejtoria në fjalë për hapësirën të cilën e shfrytëzojnë, në të kundërtën do të merret masa ligjore ndaj tyre.

Është bërë inspektimi-kontrollimi i kompanive të autobusëve dhe auto-taksit, janë kontrolluar edhe parkingjet e auto-taksive në rrugët e qytetit se mos po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale, po ashtu edhe në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare, kemi inspektuar kompanit e autobusëve që qarkullojnë në komunën e Lipjanit në lidhje me rëndetë të udhëtimit si dhe inspektimin e tregjeve si tregu i gjelbër, kafshëve dhe i mobileve.

Gjatë këti muaji janë inspektuar barnatoret bujqësore dhe shitësit e plehrave minerale me shumicë dhe pakicë, janë inspektuar tokat bujqësore mbi ndërrim destinimin e tyre si dhe ato që po mbushen me materiale të ndryshme, në bashkëpunim me policin kishim aksion mbi dëmtimin e tokave nga mbeturinat dhe materialet e tjera në rajonin Lindor të Komunës.

Janë inspektuar disa lokacione të vend ndërtimeve në objektet e ndërtimit ndaj të cilave janë ndërmarr masa ndëshkuese dhe vërejtje ndalese.